



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-32521/23  
Kaçanik, 28.12.2023

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **XI (njëmbëdhjetë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 28 dhjetor 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht kur u lexua regjistri i pjesëmarrjes ishin 23 anëtarë, ndërkohë arritën 2 anëtarë. Gjatë shqyrtimit të pikës 2 arriti Brahim Imishti, ndërkaq Fitore Vishi arriti pas votimit të pikës 2.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje apo në pjesë të mbledhjes, morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi, Drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi-DBPZHR, Zahir Doda- DA, Pranvera Loku-Zharku-DZHET, Dardana Tafili-Dauti-DAP, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Bejtulla Dalloshi, Mavije Murseli, pati edhe zyrtar tjerë të komunës. Në këtë mbledhje gjatë diskutimit të pikës 6, arritën 2 përfaqësues nga ekipi i auditimit social në Kaçanik, Projekti i monitoruar “Ndërtimi i objekteve për zjarrfikësit Kaçanik-Faza e Parë”.

Nga OSBE-mbledhjen e monitoroj: Faruk Dërmaku.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj-zyrtare në MAPL. Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit  
Procesmbajtës, Makfire Malsiu.

**Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli:** Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin duke i thirrur emër, kushte pune me u mbajtë mbledhja ka, e hapi mbledhjen e XI (njëmbëdhjetë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2023, data 28 dhjetor, me këtë:

### REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Rekomandimi i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në parcelën kadastrale Nr.70917093-00156-7, me sipërfaqe 00.55.00 ha në ZK Koxhaj, ERA PLAST – SH.P.K ;
3. Propozim Vendim për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2024;
4. Propozim Vendim për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;
5. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore në ndërtimore, në parcelën kadastrale Nr.P-70917083-00112-3, ZK Kaçanik i Vjetër;
6. Raporti i ekipit të Auditimit Social në Kaçanik, Projekti i monitoruar “Ndërtimi i objekteve për zjarrfikësit Kaçanik-Faza e Parë”.



Pika 6 ka ardhur me vonesë, me miratimin e KK do të diskutohet në këtë mbledhje. Ka qenë kërkesë e auditorëve social me u diskutuar kjo pikë, ndërkaq me miratimin e kryetarit është futur në rend të ditës për diskutim. A jeni që kjo pikë të jetë në rend pune? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Atëherë rendin e punës e atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

#### **APROVOJ**

#### **Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave.**

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Nëse ka kush vërejtje në Procesverbal, kërkoj t'i paraqitni:

**z. Agim Mani:** Procesverbali i mbledhjes se kaluar nuk përmban objektivat e transkriptit, sepse atë që e kemi thënë ne, duhet të jetë esenciale në procesverbal. Në seancën e kaluar në pozicionin pyetje dhe kërkesa, pasi që nuk arritëm me marrë përgjigje në pyetjet që i kemi parashtruar nga ekzekutivi-përkatësisht kryetari, duke ditur se përgjigjet janë obligim moral dhe ligjor me u përgjigjur para anëtarëve të KK, këmbëngulësia jonë që të marrim përgjigje të saktë që të kuptojnë qytetarët qartë, neglizhenca e ekzekutivit me u përgjigjur në pyetjet e parashtruara, erdhi deri të tensionimi i situatës në atë seancës, ku patëm edhe sulme fizike. Seancën e kemi lëshuar pas konsultimit me grupin e tonë të LVV për arsye të mosdhënies së përgjigjes së kryetarit, sulmi fizik që është bërë në atë seancë dhe ndalja e kamerave gjatë vazhdimit të seancës. Kështu është dashur të jetë edhe në procesverbal, ndërkaq në formën qysh është shënuar, ne nuk marrim pjesë në votimin e procesverbalit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë nuk e di se ka pasur sulm fizik në atë seancë. Seanca ka qenë publike, se e theksove shumë vrazhdë, megjithatë kjo është e drejta e juaj Agim.

**z. Naim Beça:** Në një përgjigje që është dhënë, pyetja ka qenë e imja, ndërkaq është dhënë përgjigja për Adnan Reka. Kjo duhet të përmirësohet. Adnani e ka dërguar kërkesën me email për me u ndryshuar, por nuk është ndryshuar.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sigurisht është bërë gabim teknik, e kemi pa reagimin e Adnanit në email. Është mirë kur ka gabime të tilla, të na njoftoni në email, se është problem nganjëherë prej incizimeve me u dëgjuar mirë. Procesverbalin e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me shumicën e votave Për 17 votë, Kundër votë nuk ka, Abstenoj Raif Kasa-LVV, ndërkaq 7 anëtarët tjerë të LVV nuk votuan. Prezentë 25. Në saje të kësaj del konstatimi se KK,

#### **Aprovoj**

**Procesverbalin e mbledhjes së X (dhjetë ) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik të datës 30.11.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-30336/23.**

#### **Pyetje dhe Kërkesa**

**znj. Ardita Rrahmani:** Meqë jemi në fund të vitit, dua të theksoj një vërejtje për ekzekutivin e komunës në mos përgjigje në pyetjet dhe kërkesat tona. Uroj që kjo mos të përsëritet në seancat e vitit 2024. Kërkesat janë:

1. Tërheqja e parkingut në rrugën "Qamil Ilazi" dhe vazhdimi i orientimit një kahe të lëvizjes se automjeteve në atë rrugë, pse po ndodhë kjo dhe cili është testi i radhës që ju e mendoni ?
2. Çka po ndodhë me mjetet e destinuara të parkingut të komunës?



3. Përse në Çerdhen QEAP "Agimi" u bënë testime rreth ngrohjes, se për 3 ditë nuk ishte funksionale ngrohja e çerdhes ?

**z. Adnan Reka:** Para se të kaloj të pyetjet dhe kërkesat, dua t'ju përgëzoj juve kryesues për reagimin tuaj, lidhur me pretendimin e biznesmenit Bashkim Topojani, sepse dikur ishte operator shumë serioz i komunës dhe partner kryesor i komunës tonë. Është i drejtë sqarimi i juaj që shqetësimet e veta Bashkimi me adresuar përmes anëtarëve të KK si përfaqësues i qytetarëve, meqë nuk i lejohet debati në KK, kjo është me u përshëndetur, se ne nuk kemi nevojë se kjo është edhe në emrin tonë me u fshehtë, pavarësisht çka pretendon, kështu që të përgëzoj për përgjigjen.

1. Kam një pyetje për drejtorin e DA dhe Drejtorin e DBF: Kur mund të bëhet kompensimi financiar i komunës së Kaçanikut lidhur me borxhin e mbetur sipas kontratës kolektive të arsimit?

2. Pasi administrata komunale ia kishte mohuar Bashkim Topojanit qasjen në dokumente publike ashtu siç e garanton ligji, Bashkimi kishte kërkuar Agjencionit për informacion dhe privatësi. Agjencioni për informacion dhe privatësi si organ kompetent, me 04.07.2023, në bazë të ligjit e detyron administratën komunale t'iu ofroj qasje komunale në dokumentet si në vijim; Kopjen e projektit për të cilën është lëshuar Leja e Ndërtimit, 06 Nr. 550/01-14579/18 me 01.03.2019 në PK 013914 Kaçanik që i bie të Posta e vjetër;

2. Kishte kërkuar kopjen e librit ndërtimor të draftit ndërtimor;

3. Kopjen e fletëpagesës së ndërtimit.

Me datën 10.07.2023 drejtori aktual z. Stagova e njofton Bashkimin se në listën e të hyrave komunale në drejtorinë e Financave, është bërë një pagesë në vlerë 50 euro e 70 cent me datën 24.08.2019, dhe drejtori thotë se është e mundur që kjo pagesë është kryer për vlerën e dëshmuar nga DUKMM, ndërsa për dokumente tjera që mbështesin këtë vlerë, nuk kemi hasur. Pyetja për Kryetarin, Cilat janë veprimet kryesore që keni marrë ju lidhur me rastin dhe çfarë keni bërë?

**z. Naim Beça:** Për çdo muaj po duhet me i përsëritur të njëjtat pyetje, në vend se me u kryer në proces rreth pyetjeve dhe përgjigjeve, ne po duhet me u kthyer në përgjigjet e juaja. Unë i kam ngritur 5 pyetje, për të cilat nuk kam marrë përgjigje, jo unë por popullata. Njëra prej tyre ka qenë: 1. Kur do të rregullohet trotuari të sheshi ? Përgjigje ka qenë: Kompania e kontraktuar për zhvillimin e punimeve të sheshit të qytetit ka të kontraktuar edhe rregullimin e trotuarit. Kështu që edhe ky pozicion krahas pozicioneve të sheshit, do të kryhet shumë shpejt. Unë nuk e kuptoj këtë të fundit, çka do të thotë, do të kryhet shumë shpejt? Trotuari është që 2 vjet i projektuar, por nuk është ndërtuar. Nëse kompania e ka të kontraktuar trotuarin, atëherë është dashur me rregulluar para 2 viteve, sepse se pari ndërtohet trotuari, pastaj vazhdojnë punimet. 2. Përgjigjen e kam marrë se kur do të ndërtohet rruga "Avdurrhim Shehu", ndërkaq kjo është rregulluar. Drejtori i DUKMM mundet me na shpjeguar se çka është punuar aty që punimet janë kryer. Unë kam bërë pyetjen kur kryhet trotuari, përgjigja ka ardhur se punimet janë kryer. Si janë kryer punimet, kur nuk është ndërtuar trotuari? Nëse mendoni për asfaltin, unë nuk kam pasur të bëjë me asfaltin, por me trotuarin.

3. Kur e kam bërë pyetjen për zjarrfikësit, pyetja është shumë e thjeshtë. Në qoftë se rekrutimi i stafit dhe makineria është kompetencë e AMF dhe AME, çfarë kompetence ka komuna? A është përgjegjësi e komunës, se nëse mjetet që i kanë kërkuar me prerë sharrën, ato nuk e di a janë në përgjegjësi të AMF dhe AME. Kërkoj që përgjigjet të jenë me konkrete e jo në mënyrë diplomatike.

**z. Agim Mani:** E falënderoj Ekzekutivin e komunës për përgjigje, pa bërë pyetje fare.

**z. Agim Çaka:** Cilat janë obligimet që ka marrë komuna për stadiumin "Besnik Begunca", sepse sipas ministrit të kulturës, komuna nuk i ka kryer obligimet që i ka marrë dhe si rezultat i kësaj është bllokuar i tërë projekti. Shqetësimin e ministrit e kam dëgjuar në seancë të



Kuvendit të Kosovës, ku është pyetur ministri për këtë çështje. Përgjigja e tij ka qenë se komuna nuk i ka kryer obligimet e saja.

**z. Rustem Zenuni:** Pyetja e Naim Beça është lidhur me trotuarin të sheshi. Unë kam qenë dje në atë pjesë dhe trotuari është kryer.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Përgjigjet i jep ekzekutivi i komunës. Kalojmë në pikën vijuese:

2. Rekomandimi i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës për 99 vite, në parcelën kadastrale Nr.70917093-00156-7, me sipërfaqe 00.55.00 ha në ZK Koxhaj, ERA PLAST – SH.P.K ;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komisioni vlerësues i formuar nga KK i ka trajtuar ofertat, nga KK kanë që 2 anëtarë: Bashkim Krasniqi dhe Bashkim Luma. Rekomandimi na ka ardhur në KK. E hapi diskutimin për këtë pikë:

**z. Bashkim Krasniqi:** Ne si komision i kemi shqyrtuar ofertat sipas shpalljes publike. Kanë qenë vetëm 2 kompani që kanë ofertuar për këtë pronë: kompania ERA PLAST- SH.P.K. dhe firma Murseli Compani. Firma e dytë nuk i ka plotësuar kriteret dhe nuk kemi mundur me ia dhënë në shfrytëzim, me vjen keq për këtë, ndërkaq kompania ERA PLAST -SH.P.K. ka pasur një ofertë shumë serioze, ka ofruar plan të biznesit shumë të mirë dhe serioz. Ne si komision kemi ardhur në përfundim se kompania ERA PLAST- SH.P.K. i plotëson të gjitha kriteret për marrjen në shfrytëzim të pronës komunale për 99 vjet. Vendimi i komisionit ka qenë njëzëri për këtë kompani. Besoj se edhe ju do të votoni njësoj, materialin e keni marrë dhe e keni pa që kjo kompani ka një plan të biznesit shumë serioz dhe kërkoj të votoni për.

**z. Agim Mani:** Komisioni vlerësues bazohet në kriteret e përcaktuara në ligj për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale. Komisioni vlerësues nuk ka tjetër kompetencë, pos zbatimit të kriterëve të përcaktuara, siç janë: vlerësimi i investimit, numrin e të punësuarve nga investimi, lloji i investimit që konsiderohet me interes me prioritet të komunës, përfitimi ekonomik dhe financiar i komunës, qarkullimi bankar në 3 vitet e fundit dhe tatimi në pronë. Të gjitha pronat të cilat janë dhënë në shfrytëzim deri me tani, janë dhënë pa plan të mirëfilltë, sepse PZHK komuna jonë nuk ka nga viti 2018. Tani jemi në vitin e 6 dhe nuk është bërë ende zgjidhja e PZHK e cili kishte me qenë një orientim i mirë për bizneset në komunën tonë dhe jo të mbesin bizneset nën mëshirën e komisionit vlerësues apo të KK. Kjo dëshmon qartë nga pronat e mëhershme të cilat janë dhënë në shfrytëzim se shumica e pronave që janë dhënë janë toka bujqësore. Tokat bujqësore duhet të ruhen për bujqësi dhe ato toka mos të epën për ndërtime të bizneseve, duke marrë parasysh faktin se komuna jonë ka me se paku toka bujqësore, dhe nëse këto prona i tjetërsojmë, do të mbetemi pa bujqësi. Ekzekutivi i komunës duhet të ketë plan afatgjatë dhe t'i orientoj bizneset në mënyrë të duhur dhe mos të ikin qytetarët në shtetet fqinje, për mos planifikimit të komunës në orientimet e tyre. Për derisa nuk ruhen tokat bujqësore, ne do të jemi kundër këtyre investimeve.

**z. Bashkim Krasniqi:** Po lidhem me diskutimin e Agimit, ia bëj me dije Agimit se kriteret e përcaktuara kjo kompani i ka plotësuar të gjitha. Kur e kemi miratuar ofertën e kësaj kompanie, jemi bazuar në letra, në fakte e jo në hipoteza, ndërkaq se çka ndodhë në të ardhmen, ne nuk mundemi me ditur. Ofertën që e ka bërë kjo kompani, ka qenë shumë serioze, ka plan shumë bindës, ndërsa se a ka me investuar apo jo, nuk mundemi me ditur, ndërkaq me letra është në rregull. Kjo kompani ka pasur një plan shumë bindës dhe nuk kemi mundur me i thënë ndryshe si komision.



**z. Agim Mani:** Komisioni nuk ka kompetenca tjera, përpos përmbajtjes së kritereve, mirëpo tani pyetja është për ekzekutivin. Komisionin e përgëzoj për mbajtjen e kritereve. Shtrohet pyetja, ekzekutivi a e ka kryer punën e vet? Çka nëse dështon, pasi toka është bujqësore? Këtu është gabimi i parë i ekzekutivit, sepse ekzekutivi duhet me ua rregulluar infrastrukturën bizneseve, pastaj me filluar me procedurën. Unë komisionin nuk e fajësoj shumë, sepse nuk ka shumë kompetenca, përveç se me bërë një vlerësim në bazë të kritereve, ndërkaq kompetencat i ka ekzekutivi i komunës, i cili në këtë rast ka dështuar në start.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në momentin që komuna bënë investime, komuna duhet me i pasur në dispozicion pronat, sepse hapet vlera për investitor me aplikuar përmes shprehjes së interesit. KK vendos, ndërkaq është fatkeqësi që nuk është miratuar ende PZHK. Lista është e miratuar në KK, është vlerësuar nga MAPL, ato prona janë në faqen zyrtare për të gjithë të interesuarit. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për, 18 votë, Kundër 7 anëtarë të LVV, Abstenoj Raif Kasa-LVV. Prezentë 26. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë :

#### VENDIM

**Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për nëntëdhjetenëntë (99) vjet pronën e paluajtshme të komunës në Parcelën Kadastrale Nr. P-70917093-00156-7 në Zonën Kadastrale Koxhaj përmes Shprehjes së Interesit, ERA PLAST – SH.P.K. në Doganaj të Kaçanikut, sipas rekomandimit të komisioni vlerësues/ Lënda: 01Nr. 104/02-30266/23.**

3. Propozim Vendim për aprovimin e Listës së pronave komunale që planifikohen të epën në shfrytëzim në vitin 2024

**Kryesuesi i Kuvendit:** Është me ligj e përcaktuar miratimi i listës së pronave, ministria kërkon që pronat të cilat jepen në shfrytëzim të hartohet lista e tyre dhe të miratohen në KK deri në fund të vitit paraprak për vitin vijues. Propozimi është bërë nga DUKMM. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Përse nuk e keni hartuar edhe listën e përgjithshme të pronave të cilat epën në shfrytëzim, por vetëm listën e veçantë? Sipas juve, cila është lista e veçantë dhe cila është lista e përgjithshme, se ligji përcakton këto lloje listash? Lista e veçantë duhet të ketë përmbajtje të veçantë Për secilën listë duhet të caktohet destinimi, periudha e dhënies në shfrytëzim. Nëse është listë e veçantë që e keni lënë me prioritet sipas planit të juaj për zhvillim ekonomik, pyetja është: A keni plan për këto lista të veçanta, se në listë keni futur me i dhënë në shfrytëzim mbi 100 ha në Kotlinë? Cili është plani për pronën në Kotlinë? Mirë që tanë iu ka rënë ndërmend për këtë fshat të braktisur nga pakujdesia e juaj, dhe tani mendoni me ngritur ekonomikisht këtë fshat dhe disa fshatra tjera. Mendoj se çdo herë duhet respektuar ligji, thirrreni në ligj, ndërkaq nuk respektoni ligjin. Aty ku nuk respektohet ligji, nuk do të keni përkrahjen tonë.

**znj, Ardita Rrahmani:** Në mbledhjen e fundit të KPF kam kërkuar që parcelat të cilat janë të reja, të specifikohen se cilat janë. Ato ditë në mbledhje të KPF u tha se do të specifikohen parcelat e reja, por kjo nuk është bërë, shpresoj që vitin tjetër kjo të bëhet. Ne nuk e dimë për pronat se për ku bëhet fjalë, premtimi i juaj ishte se përmes dy TV, do t'i shohim në KK. Uroj që në fillim të vitit 2024, me pas të zgjidhur këtë problem.

**z. Agim Mani:** Ne kërkuam me ditur cila është lista e përgjithshme dhe ajo e veçantë, se edhe ligji përcakton këto lloje të listës së pronave. Ju i keni numrat dhe mund të kaloni këtë listë, ndërkaq mendoj se jeni duke bërë shkelje ligjore.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Drejtor na bënë dallimin në mes listës së përgjithshme dhe asaj të veçantë?



**z. Qamil Stagova:** Nuk kam përgjigje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Dy TV janë, por nuk janë vendosur ende. Nëse nuk e kam gabim, Lista e përgjithshme është lista totale e pronave që figurojnë si prona komunale. Lista e veçantë nuk janë të gjitha pronat e komunës, si çështja e pronës që e ndamë për varreza, edhe pse nuk kaloj në ministri, se ishte pengesë PZHK.

**z. Agim Çaka:** Lista e veçantë është e përfshirë në listën e përgjithshme. Kërkojmë sqarim pse duhet të jetë e veçantë kjo listë, a ka bërë kush klasifikim të pronave? Nëse lista e veçantë është brenda listës së përgjithshme, mendoj se nuk ka asgjë të keqe.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Mendoj se quhet listë e veçantë, sepse jepet për destinim të veçantë. Lista e veçantë sepse është nxjerrë nga lista e përgjithshme, nuk është tërësia e pronave, por disa prona që komuna planifikon me i dhënë në shfrytëzim. Lista duhet me u publikuar, ndërkaq ka mundësi që për shumicën e pronave si në listë, të mos ketë kërkesa fare, por si listë publikohet për të interesuarit, pavarësisht se ku janë. Pse votohet dhe publikohet lista e veçantë e pronave të komunës, nuk paraqet kurrfarë problemi, ndërkaq a jepet për qëllime të caktuara, ne si KK kemi me u marrë pastaj me Vendim paraprak për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim dhe formimin e komisioni vlerësues.

**z. Adnan Reka:** Edhe njëherë po kthehemi të neni 13 që e potencoj Agimi, pika 2 e ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, ku thotë: Lista e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbaj këto të dhëna kadastrale të pronës: qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale. Të gjitha këto mungojnë. Unë e pashë që edhe hapësira e Kalasë është në kuadër të kësaj listë me u dhënë në shfrytëzim. Si mund të nxjerrën pronat komunale në shfrytëzim, pa ditur qëllimin, destinimin? Për pronën e rekomanduar e cila u dha në shfrytëzim, qysh në start këto janë në kundërshtim me ligjin. Po ia potencoj Bashkimit se ligji është shkelë në hapin e parë të lista që ka dalë, se lista se nuk i ka përmbajtur këto të dhëna, që duhet dinë ofertuesit të cilët ofertojnë, ndërkaq në hapin e dytë ka qenë komisioni. Të Kalaja, fjala vjen, unë mundem me marrë pronë, por nuk mundem me hapur fabrikë, se ligji nuk e lejon, se ligji thotë duhet të përmbaj qëllimin e dhënies në shfrytëzim. Unë bëj pyetje: A i përmban lista kriteret e përcaktuara si në ligj?

**z. Qamil Stagova:** Se çka përmban lista e veçantë e pronave, veç po shihet. Deri tani pronat që janë dhënë në shfrytëzim kanë qenë në bazë të kërkesave të firmave dhe mendimeve të ekzekutivit. Në bazë të kërkesave të cilat na janë paraqitur gjatë kohës, ne kemi ardhur në përfundim se cilat prona mund të japim në shfrytëzim. Se çka përmbajnë, shihet të dhënat kadastrale, lista duhet me u bërë publike, sepse nëse një pronë nuk është në listë, nuk mund të jepet në shfrytëzim në vitin 2024. Për çështjen e pronës në Kotlinë që u përmend nga Agimi, mundeni të quajmë si të doni, por çështja është se ky është problem shumë me i ndërlikuar që nuk arsyetohet me një fjali.

**z. Adnan Reka:** Në formën si është lista pa këto kriteret, a është ndeshë me ligjin?

**z. Qamil Stagova:** Nuk e di a është ndeshë me ligjin, ndërkaq MAPL çdo herë e ka vlerësuar të ligjshme listën e pronave për me i dhënë në shfrytëzim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pjesën me të madhe të asaj që e kërkon ligji, lista e përmban, si të dhënat kadastrale, zonat kadastrale, qëllimi është me u dhënë në shfrytëzim pronat për afatgjatë kohor. Qëllimi është destinimi, i cili përcaktohet në bazë të kërkesave, vlerësimit të komisionit dhe të KK se një pronë a lejohet për një veprimtari të caktuar. Çështjet janë të qarta, se qëllimi është me u dhënë në shfrytëzim për investime, mungon destinimi i cili pritet me u pa sipas



kërkesave dhe nevojave që paraqiten dhe ai destinim mundet me u aprovuar apo refuzuar nga KK.

**z. Agim Mani:** Unë mendoj që nuk duhet të epën në shfrytëzim pronat komunale në bazë të kërkesave, por në bazë të planit të ekzekutivit. Cili është plani i ekzekutivit në këtë rast, se orientimin e bizneseve e bëjnë ekzekutivi, e jo kërkesat e qytetarëve. Kërkesat janë, por nuk ka plan ekzekutivi. Cili është plani fjala vjen për kalanë e qytetit? Për atë është lista e veçantë, ka një përmbajtje me të vogël, e jo me u dhënë 100 ha përnjëherë, ndërsa me listën e përgjithshme jam dakord me u dhënë 100 ha përnjëherë, se nuk munden me u dhënë në 2024 gjithë këto prona, mundet të jepen 4-5 prona nga kjo listë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne mundmi me bërë plane, por mos me pasur kërkesa. Duhet me iu ofruar mundësi personave për me investuar. Për secilën pronë ka me ardhur këtu Propozim Vendimi dhe kemi me debatuar për destinimin. Mos mendoni se plani ka me na i zgjidhur krejt problemet. Diskutime tjera nuk ka, e shtoj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për 15 votë, Kundër ish-in 7 anëtarë nga LVV, Abstenuan 5 anëtarë (4 anëtarë nga LDK dhe anëtari Raif Kasa-LVV). Prezentë 27. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

#### VENDIM

**Për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2024/ Lënda: 01Nr. 104/02-32234/23.**

5. Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kuvendi i Komunës e ka hartuar një plan pune për hartimin e planit të punës së KK për vitin 2024. Plani është orientues, nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime dhe plotësime. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë

#### VENDIM

**Për aprovimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024/ Lënda: 01Nr. 104/02-32223/23.**

5. Propozim Vendim Paraprak për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore në ndërtimore, në parcelën kadastrale Nr.P-70917083-00112-3, ZK Kaçanik i Vjetër;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Të emërtimi duhet të jetë Propozim Vendim Paraprak. E hapi diskutimin:

**z. Betim Shala:** Unë nuk besoj se ky vendim kalon në qeveri, sepse ata e kanë dhënë njëfarë sqarimi që nëse ndërrim destinimet nuk janë me PZHK, nuk kalojnë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Atë mendim e kam edhe unë, se na i kanë kthyer ndërrim destinimet që i kemi marrë me herët, se po kërkojnë të jenë në harmoni me PZHK. Ne po përballemi me kërkesa të qytetarëve çdo ditë. Këtu bëhet fjalë për një person që donë me rritur biznesin e vet. Edhe me PZHK të ri nuk kemi me pasur mundësi me i trajtuar krejt kërkesat dhe përsëri kemi me u përballë me të njëjtat, se është vështirë me i ditur orientimet tyre. E hapi diskutimin:

**z. Agim Mani:** Unë mendoj se nëse jeni të sigurt se na kthehet ky vendim nga ministria, atëherë mos të marrim miratojmë, nëse e dini se vendimi nuk është në harmoni me ligjin apo rregulloren. Parashtruesi i kërkesës me nr. 06/350/01-32279/23 ka paraqitur kërkesë në DUKMM me 14.12.2023. Pas pranimit të kërkesës se Mensur Dullovi, nga kjo drejtori,



komisioni ka dal në vendngjarje, ka konstatuar gjendjen faktike. Prona është e klasës 1 sipas certifikatës. Parcela është në Kaçanik të Vjetër, sipas PZHK është digjitalizim i pyjeve dhe kufizohet me autostradën "Arber Xhaferi" në lartësi 100m. Nëse bazohemi në konstatimet e komisionit të nenit 5 të paragrafi 1.2 e Ligjit për planifikim hapësinor, planifikimi i nivelit lokal në tërë territorin e komunës së Kaçanikut, përmes dokumenteve të planifikimit hapësinor siç janë: PZHK, Harta zonale e komunës dhe Planet rregulluese dhe neni 1,2 dhe 3 janë bazë për ndërrimin e destinimit të tokës, dhe nëse tejkalojmë këtë nen, bëjmë shkelje ligjore. Kjo tregon se ekzekutivi i komunës nuk ka arritur të ofroj dëshmi të mjaftueshme për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore e klasës së parë, në tokë ndërtimore, pasi parcela është pronë private dhe mund të jetë e favorshme, për zhvillimin e veprimtarisë biznesore, zbutjen e papunësisë në nivel lokal. Për atë ekzekutivi duhet të ketë kujdes me të madh që t'i ndihmoj bizneset me një plan afatgjatë, se mungesa e një plani të tillë, i sjellë bizneset tona komunale në këtë gjendje. Kjo mbetet në ndërgjegje të ekzekutivit dhe ne nuk mund të përkrahim diçka që është në kundërshtim me ligjin dhe me PZHK. Raste të tilla kemi pasur me herët afër këtij lokacion për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, andaj diçka që nuk është e ligjshme që nuk ka bazë, nuk mund të përkrahim.

**z. Agim Çaka:** Çdo vendim që marrim këtu, kisha dashur të mos jetë në kundërshtim me ligjin dhe me na kaluar në MAPL. Në bazë të praktikës, ka ndodhë e kundërta, përkundër që kemi marrë vendime në interes të qytetarëve, nuk kanë kaluar në MAPL. Për këtë arsye duhet që qytetarët me ditur saktë se ku është problemi, se nëse ne nuk e votojmë këtë vendim, qytetari mendon se ne nuk jemi duke dashur me aprovuar. Ne jemi duke dashur me marrë vendim, për një çështje e cila nuk kryhet, për këtë arsye ne duhet ditur dhe ekzekutivi duhet ditur se nuk mund të kryhen do punë, pa u kryer do punë tjera dhe ministria ka të drejtë që kërkon me qenë në harmoni me PZHK. Këtë duhet me ua bërë me dije qytetarëve. Unë kam me votuar këtë vendim, pavarësisht kësaj, unë nuk jam duke e shkelur ligjin, se jam me iu hapur rrugë qytetarëve me punuar, pastaj çështja tjetër është në përgjegjësi të dikujt tjetër.

**z. Adnan Reka:** Unë mendoj se jemi jo korrekt edhe me qytetarët, se për diçka që e dimë që po e shkelim ligjin, ligjin e rrugëve, se prona është larg 100m prej rrugës, pastaj ligjin për rregullimin hapësinor, i cili thotë se duhet me pasur plan rregullues të hollësishëm, pastaj ligjin për tokën bujqësore, ku ndërrimi i destinimit nuk mund të filloj të përdoret për qëllime jobujqësore, nëse nuk është me planin hapësinor respektivisht me PZHK me të cilës asaj toke paraprakisht i është caktuar destinim tjetër. Ne po e dimë saktë se jemi ndeshë me 3 ligje, dhe e mashtrujmë qytetarin se do ta kalojmë, ndërkaq ministria është ajo që na e kthen. Në këtë rast ne jemi jo korrekt, se ne vetëm po bëjmë mashtrim të qytetarit, ndërkaq KK nuk duhet me rënë në atë nivel, se KK duhet të jetë organ serioz, se nëse një çështje është në kundërshtim me ligjin, nuk duhet me kaluar, ndërkaq duhet të përballemi me qytetarin.

**Kryesuesi i Kuvendit:** E njëjtë ka qenë edhe me herët, kanë qenë do vendime që janë kthyer që nuk kanë qenë me PZHK, por ka pasur edhe që nuk janë kthyer edhe pse nuk kanë qenë me PZHK. Meqë PZHK ka ngecë, por edhe pas miratimit të tij kemi me pasur kërkesa që kemi me i miratuar në këtë KK, se kërkesat janë të ndryshme, ne nuk mund të parashohim çdo kërkesë, dhe kemi me bërë ndërhyrje të arsyeshme në PZHK. Duhet pasur kuptim edhe niveli qendror se vendimi është i KK që e ka miratuar edhe PZHK, mund të kemi hapësira për këto çështje, se nuk mundemi me paragjykuar se çka do të ndodhë në të ardhmen për 10 vjet për me u zhvilluar dhe ndërtuar. Janë kriteret që përcakton ligji, megjithatë kërkesat që janë me specifike duhet të trajtohen dhe të përkrahen. Diskutime tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua me shumicën e votave Për 18 votë, Kundër ishin 8 anëtarë (7 anëtarë nga LVV dhe Besnik Salihu- LDK), Abstenoj Raif Kasa-LVV. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:



## VENDIM PARAPRAK

Për ndërrimin e destinimit të tokës pyjore në ndërtimore, në parcelën kadastrale Nr.P-70917083-00112-3, ZK Kaçanik i Vjetër/ Lënda: 01Nr. 06-350/02-32279/23.

6. Raporti i ekipit të Auditimit Social në Kaçanik, Projekti i monitoruar “Ndërtimi i objekteve për zjarrfikësit Kaçanik-Faza e Parë”.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ka qenë kërkesë me qenë në rend pune ky raport, drejtori është këtu, kanë qenë të ftuar edhe ata të raportit, për momentin nuk qenkan këtu, e hapi diskutimin:

**z. Adnan Reka:** Raporti i auditorit social ka nxjerrë në pah shumë gjetje dhe shumë defekte. Auditori social është një grup i qytetarëve profesioneve të ndryshëm, që është krijuar nga BIRN dhe HELVETAS që kanë monitoruar punët e komunave. Në diskutimin e raportit me komunitetin, në raportin e auditorit thuhet: Përfaqësuesit e fshatit Kovaçec, kishin kundërshtuar ndërtimin e objektit në atë vend, me pretendime se ka varreza të te parëve të tyre. Të gjithë e dimë se aty ende i thonë varret e tronëve, është shumë e qartë se aty ka pasur varreza, ndërsa arsyetimi i komunës është se aty afër gjendet kompania e pastrimit dhe po tentohet me bërë një zonë të kompanive komunale. Kjo është e paarsyeshme plotësisht. Të publiciteti i dokumenteve të projektit, disa materiale të rëndësishme rreth këtij projekti mungojnë. Gjetjet tregojnë se është publikuar kontrata e nënshkruar në mes komunës dhe kompanisë ndërtuese, mirëpo e njëjta nuk ishte e plotë. Në kontratën e publikuar të E-prokurimi, mungonin punët që ishin paraparë të realizoheshin si dhe çmimi për secilin pozicion. Ekipi po ashtu konstaton se komuna e Kaçanikut nuk kishte publikuar në mënyrë por-aktive dokumentet tjera, raportet e mbikëqyrjes apo faturat e pagesave, të cilat nuk ishin publike në faqen e komunës. Pse me i fshehur e mos me i publikuar ? Mbikëqyrja e kontratës, një element i rëndësishëm që ekipi konstaton që qytetarët e zonës nuk kishin njohuri se kush ishte mbikëqyrësi i projektit. Në tabelën e shpalljes se projektit, komuna e Kaçanikut nuk i kishte njoftuar qytetarët as për emrin e mbikëqyrësit të projektit dhe kontaktet e tij. Pse me fshehur mbikëqyrësin e projektit? Procesi i planifikimit, ekipi ka gjetur se projektimi jo i duhur i disa çështjeve ka sfiduar mbarëvajtjen e projektit dhe ka krijuar nevojë për ndryshim të projektit gjatë rrugës. Objekti dhe funksionimi i tij, ekipi i auditimit nuk është njoftuar nga komuna se ka marrë masa ndaj kompanisë, e cila gjatë fazës së parë, nuk e ka paraparë izolimin e bodrumit të objektit. Ekipi ka vërejtur se objekti ka hapësirë të ngushtë, që pamundëson që të ketë hyrje dhe dalje në dy anët e objektit, ka vetëm 3 dyer hyrëse për 6 makineritë që posedojnë zjarrfikësit e komunës së Kaçanikut. Ekipi vlerësues, vlerëson se kemi të bëjmë me objekt të karakterit publik, dhe ka vlerë të investimeve të lartë, dhe është mirë të ketë konkurs publik projektues. Analizat e objektit të ndërtuar, në këtë hapësirë ekipi ka konstatuar se disnivelet apo shkallët në zonën ku njerëzit janë të prirur të vrapojnë, nuk janë të rekomandueshme. Gjithashtu ekipi ka konstatuar se në objektin e zjarrfikësve, nuk ka tub për me zbritur zjarrfikësit, i cili u mundëson zjarrfikësve të zbresin nga kati i sipërm në të cilin i kanë dhomat e pushimeve. Gjatë analizimit të dokumenteve dhe vizitave në terren, ekipi ka gjetur se në planifikim kompania projektuese kishte harruar të parashihte izolimin e podrumit. Po ashtu është evidentuar se objekti ka hapësira të pashfrytëzueshme, ndërsa mungojnë hapësirat e dedikuara për ushtrime të zjarrfikësve. Eliminimi i ofertës me të lirë, në tenderin e parë, që ishte planifikuar vetëm ndërtimi i pjesës së vrazhdë, komuna e Kaçanikut kishte pranuar 5 oferta. Kompania NPN Euroing SHPK ishte rekomanduar për kontratë, pasi kishte ofertën 239,996 euro. Implementimi i kontratës, problem i evidentuar gjatë menaxhimit të kontratës, ishte krijimi i disnivelit në mes të garazhës në të cilën parkohen kamionët e zjarrfikësve dhe pjesës së objektit që janë të vendosura zyrtar. Sipas menaxherit të kontratës, kjo ka ndodhë për faj të planifikimit. Ai ka



treguar se nuk janë planifikuar me kohë që në pjesën e zyrave duhet të bëhet nivelizimi dhe kjo ka bërë që të ketë një prej 10 cm. Ndryshimi i kontratës-largimi i pompës termike, ekipi ka gjetur se kontrata ishte ndryshuar pas fillimit të punimeve. Fillimisht është bërë një ndryshim i kontratës duke shtuar sasinë e punës që duhet të kryheshin në disa pozicione, dhe duke ulur pozicione tjera. Këto ndryshime ishin bërë duke u bazuar në kërkesën e datës 22.12.2022 nuk e kishin ndryshuar vlerën e kontratës, që do të thotë, nuk kishte nevojë për kontratë të re. Një prej ndryshimeve që ishte bërë në këtë kontratë është pompa termike që ishte vendosur në tender dhe ishte pranuar oferta, por pas ndryshimit të kontratës, kjo ishte hequr. Zvarritja e punimeve, komisioni për pranimin teknik është ekip profesional i komunës, i cili në fund të projektit inspekton punimet dhe në bazë të raportit të këtij ekipi, punët pranohen dhe kryhet pagesa. Gjatë realizimit të projektit, menaxheri kishte kërkuar edhe një kontratë të re emergjente për punë shtesë, me kërkesën e bërë nga menaxheri i kontratës, thuhet, se me punë shtesë parashihet dislokimi i kabllave elektrike të tensionit të ulët dhe disa pozicione tjera në objekt, pozicione të nevojshme për përfundimin e projektit. Bazuar në kërkesën e menaxherit të projektit, komuna kishte nënshkruar kontratë në vlerë prej 23,672euro me operatorin e njëjtë. Kontrata e nënshkruar me 04.08.2022 ishte planifikuar të finalizohet për 60 ditë pune, por punët ishin finalizuar në muajin prill 2023, 8 muaj pas kontratës. Një shkarje tjetër mes menaxherit të projektit dhe komunës është, në arsyetimin e menaxherit të kontratës, është thënë; ndryshimi i kontratës për pompën termike, është i nevojshëm, si rrjedhojë e mospërputhjes së projektit kryesor me paramasën. Përgjigja e komunës, këtu nuk ka të bëjë me pompë termike si pajisje, por me mjete përcjellëse të pompës termike, gypa të cilat nuk mund të punoheshin pa pajisje tjera para fazës së dytë. As menaxheri i projektit nuk i kanë harmonizuar çështjet me komunën.

**z. Agim Mani:** Është shqetësuese në këtë rast gjendja e ekzekutivit, marrë parasysh në këtë projekt, që auditorët social kanë gjetur shkelje jashtëzakonisht të shumta. E mira e ekzekutivit është që ky auditor nuk ka bërë auditime tjera, se po të kishte bërë auditime në projekte tjera, shkeljet kishin me dalë marramendëse. Besoj që mjafton ky projekt me gjithë këto të gjetura, që ekzekutivi të përmirësohet. Për atë kërkohet që projekti qysh në fillim që të nisën mirë që përfundimi i punëve të bëhet mirë, se projekti ka dështuar në fillim, se nëse nuk nisën mirë, punët na vijnë në fund si në këtë projekt. Adnani i ceku të gjitha shkeljet e potencuar nga auditori, një prej tyre: auditori thotë: Nuk janë përfillura rregullat e sigurisë së shëndetit në punë. Ligji për Siguri dhe Shëndetin në punë, zbatohet me vonë, pasi të kryhen punimet e vrazhda dhe të fillon puna. Për secilin vend veç e veç bëhet vlerësimi i rrezikut në punë. Nëse në këtë rast ka shkelje në start, nuk ka me pasur mundësi me bërë vlerësim të riskut të rrezikut sidomos të zjarrfikësit të cilët kanë rregullore të posaçme, d.m.th. ka me pasur vështirësi në të ardhmen, sepse faza fillestare nuk ka shkuar si duhet. Ne po duam që në start punët të nisën ashtu si e kërkon rregullorja, ndërkaq përkushtimi i ekzekutivit me qenë serioz, e jo në këtë formë, se një projekt me gjithë këto të gjetura, është mjerim. Ekzekutivi duhet me u vetëdijësuar e me ditur se cila është përgjegjësia e tij, njerëzit me qenë me përvojë, nuk i përdorë kapacitetet profesional në vende të duhura, për atë janë këto shkelje, besoj se edhe në projekte tjera ka shkelje të cilat ne nuk i dimë, se nuk i kemi ditur edhe të ky projekt.

**z. Selajdin Troni:** Unë kam pasur telashe, të pjesa e konsultimeve me banorë, e kam pyetur edhe drejtorin se a është pronë komunale? Përgjigja ka qenë, po është pronë komunale. Në parcelë shkruan se është pronë komunale, aty janë varret e tronëve. Aty u ndërtua objekti i pastërtisë, tani po ndërtohet objekti i zjarrfikëseve. Unë e kam pyetur edhe drejtorin pse nuk i keni thirrur me i konsultuar banorët? Përgjigja ka qenë se është pronë komunale. Si do që të jetë, është mirë me iu treguar banorëve se mundem me ndërtuar aty diçka. Është fat i mirë që nuk ka pasur mbetje të eshtrave, ndërkaq shihet që pronë është e komunës. Të pjesa e emergjencave, unë jam i asaj fushe – magjistër i emergjencave dhe i kuptoj çështjet. Drejtori



nuk ka bërë parandalim aty, se objekti nuk është ndërtuar sipas parametrave që kërkohet, as nuk ka reaguar me i parandaluar ndërtimet, por krejt parandalimi kanë shkuar në tre kende, se emergjenca i ka tre elemente: parandalim, reagim, ri këmbje. Të ri këmbja ka kushtuar diku 23,263€. Nëse ka edhe pjesë tjera që kanë me u ndërtuar aty, se ka me u ndërtua një aneks, është mirë me ua sqaruar komunitetit se a është parcelë e komunës, apo janë varreza.

**z. Agim Çaka:** Me vjen mirë që ka ardhur një iniciativë e tillë e ekipit të auditimit. E tha edhe Agimi se është keq që nuk ka edhe auditime në projekte tjera, unë mendoj se duhet me pasur edhe në projekte tjera auditime të tilla, se u pa se kishte shumë shkelje, kjo është shqetësuese. Qëllimi i ekipit ka qenë që përmes KK kjo me ardhur edhe para qytetarëve që me pa sa shkelje janë bërë në këtë projekt. Unë mendoj se ka shkelje edhe në projekte tjera, është mirë me ndërhy dhe me pasur parasysh këto shqetësimet tona. Ekzekutivi i komunës me i marrë me serioz këto punë, sepse edhe të halla sportive të terrenet sportive, shihet se është mbledhje uji, ku janë shpuar nja 2 vrima, se nuk kanë mundur me bërë nivelimin që është një prej proceseve me të lehta me teknologjinë e zhvilluar. Unë mendoj se edhe në projekte tjera ka lëshime të mëdha, kështu që është mirë me pasur këso lloj auditimesh.

**z. Ramadush Osmani:** Nuk kemi të bëjmë këtu me auditim profesional, se auditori profesional din çka kërkon, por kemi të bëjmë me një format të ri, që e ka propozuar programi DEMOS, që jemi përfitues të atij projekti. Kemi të bëjmë me një ekip të auditimit të shoqërisë civile, që transparenca komunale e mundëson me u involvua me ardhur me pa. Kjo nuk do të thotë që janë profesional. Ky është këndi i tyre i perceptimit sesi e kanë pa projektin, i keni emrat e tyre. Komuna përmes projektit që e ka përfituar, pjesa e I, ka lidhur Memorandum me rrjetin ballkanik gazetari për me auditu këtë projekt përmes auditimit social dhe janë involvuar persona që janë qytetari aktive, njerëz që janë të interesuar për me ditur sa me tepër për projektet që i ekzekuton komuna përmes mjeteve komunale. Prandaj ky projekt ka me iu nënshtruar edhe auditimit vjetor që vjen nga ekipi e auditorit të përgjithshëm që auditon pasqyrat vjetore financiare. kjo është formë e re-format i ri, që ne si komunë ia kemi mundësuar një ekipe për me u involvua me pa se çka është bërë dhe i jepni propozimet. Nuk janë ato shkelje që bash qysh po thoni ju. Ky projekt ka projekt ekzekutues, hartuar nga kompania profesionale, e cila është me kontratë aktive të komunës. Detyrat projektuese iu ka dhënë, lokacioni iu ka dhënë, dhe iu kemi kërkuar të hartoj projekt për shërbimin e zjarrfikësve, është projekt pak më specifik, detyra projektuese iu ka dhënë me specifika të njësisë së Kaçanikut, me specifika e lokacionit, ne këtë lokacion e kemi, kaq pronë komunale ka komuna të përshtatshme për këtë shërbim. Shërbimin e zjarrfikës nuk mund të vendosim ku të duam ne, sepse duhet të jetë i vendosur ku intervenimi bëhet me shpejt. Ky është vlerësuar lokacioni me i përshtatshëm edhe nga shërbimi i zjarrfikës, sepse lidhet me magjistralen dhe rrugët dytësore lokale të Kaçanikut dhe vjen me shpejt të intervenimi. Të gjeturat që po i potenconi, nuk është diskutuar ende, ky projekt ka qenë në listën e projekteve kapitale i cili iu ka nënshtruar debatit publik. Ata që kanë qenë të interesuar, e kanë pa të koduar, ka qenë edhe në kuvend të komunës në listën e projekteve kapitale. Mirë është për secilin projekt kapital, me pasur debat edhe me grupet e interesit. Ne e patëm fjalën e kryetarit në debatin e fundit, që ka pasur njoftim publik, mirëpo do të praktikojmë të bëjmë debate për këso projekte edhe me komunitetin se ku investojmë. Parcela është pronë komunale, ZK Kaçanik, edhe pse historikisht thuhet se janë varret e tronëve, por me fletë poseduese shënon ZK Kaçanik. Para se me bërë këtë projekt, ne kemi bërë ndarje të parcelës, ku pjesa ku ka me u ndërtua objekti, është ndarë edhe fizikisht. Është vlerësuar se a ka varreza apo jo, edhe pse në afërsi janë varrezat. Janë evidentuar çështje teknike të cilat gjatë ekzekutimit kanë dalë, se asnjë projekt nuk mundemi me projektuar 100%, se është kompani projektuese që e ka harruar gjatë projektimit me qenë edhe izolimi i podrumit,



por menaxheri i projektit e ka thënë se nuk mundesh me vazhduar me punime, pa e izoluar pjesën e podrumit, për atë është që gjatë punimeve me u evidentuar nevojat të cilat kanë dalë me aneks kontratë- punë shtesë. Inxhinieri me kohë e heton, se punët shtesë lejohen deri 10% për efikasitet të projektit. Disniveli, 10 cm. Pjesa e garazhit me pjesën e administratës, e cila sanohet me një rampë lëvizëse. Ka pasur mundësi me u niveluar edhe për 10cm., por nuk është diçka që problem. Ekipi i auditimit e ka pa se mungon krahu, pjesa ku tubi zbrit, por kjo se ka penguar projektin se kjo mund të rivendoset, sepse hapësira është, edhe sot askund në Kosovë nuk e ka. Mirë është me pasur, sikurse ia kemi vendosur ashensorit qendrës “Skënderbeu”, është një diçka që rivendoset. I ka 3 dyer, aq është hapësira, janë 6 makineri i menaxhon shërbimi i zjarrfikës, se nuk mundet me iu krijuar hapësira për 6 dyer, por i rendit brenda krahut të saj dhe nuk ka ndonjë pengesë të kësaj natyre. Punët shtesë, gjatë punimeve të gërmimit, dalin punët shtesë, si çështja e kabllove të rrymës të tensionit të lartë, të cilat as KEDS nuk ka treguar saktë se ku i ka, për atë duhet ekupe detektues me i gjetur kabllo në formë shumë graduale, të cilat kanë ndikuar në dinamikën e projektit. Pjesët tjera, mirë është me qenë edhe kontrata, krejt janë dokumente që kush është i interesuar, mundet me i gjetur, tash edhe publikohen, kontrata dhe pjesa ofertuese, këto janë çështje të prokurimit. E potencuan një detal, për atë themi mos të marrim shumë profesional, pozicionet në paramasë janë të emëruara, pompat termike, e ka pompën, i ka gypat, por si pozicion quhet pompë termike. Aty nuk kemi ofertues, kompania e ka paraqitur si pozicion dhe nuk mundemi me i thënë me hequr pompën termike. Projekti është ndarë në 2 faza, për shkak të mjeteve, faza I- ndërtimi i vrazhdët, faza II- pjesa që është duke u punuar. Gjatë ndarjes në faza, inxhinieri e ka obligim pjesët që patjetër duhet me u kryer në fazën e I, në mënyrë që faza e II të kontraktohet me pjesët e mbetura. Gjatë këtyre ndarjeve, është dashur inxhinier me paraparë nën ybërcuk gypat e ngrohjes, këto janë elemente në vlerë 1200-1300012€. Është një ndër projektet me të mira të ekzekutivit, me mbikëqyrje dhe është duke u punuar me projekt në detaje. Pse nuk ka pasur izolim, izolimi do t’i bëhet.

**z. Naim Beça:** Shumë herë e përmendet që ekipi i auditimit nuk është profesional, paramendoni po të ishin profesional, është harruar me u bërë izolimi i podrumit, shkallët, nuk janë gypat kryesor, atëherë çka prisni ju prej atij inxhinieri. Kjo për zjarrfikësit është elementi kryesor që kur zbrit nga dhomat zbriten të kamionat me intervenuar shpejt. Po të ishin profesional, gjetjet do të ishin shumë me të mëdha, këto janë gjetje të ekipës, që ua kanë lehtësuar punën juve.

**z. Agim Mani:** po lidhem me fjalët e drejtorit i cili theksoj se është një ndër projektet me të mira, e themi me keqardhje vet fjala të bënë me kuptuar se projektet tjera janë ende me keq se ky. Nëse nuk shfrytëzohet aneks projekti 10%, secili që e merr projektin, në start e bënë të detajuar, në bazë të projektit, kryhet pagesa, se kjo po jep mundësi që projekti me pasur aneks 10%,. Të ekipa e auditimit që thuhet është joprofesional, komisioni ka kërkuar dokumentacione dhe ka bërë raport në bazë të dokumenteve dhe planit të projektit, e ka dhënë mendimin e vet dhe nuk ka nevojë me qenë shumë profesional këtu, ndërkaq në këtë komision ka pasur grupe të ndryshme të interesit, ka inxhinier, arkitekt, zjarrfikës, kështu nuk mundeni të thoni se nuk është profesional.

**z. Ramadush Osmani:** NukUnë thashë jo profesional në aspektin e profesionit të tyre, është ekupe auditiv, këta nuk janë auditor profesional. Auditor profesional janë ata të cilët vinë çdo vit për pasqyrat financiare, ndërkaq këta janë ekupe me profesional të ndryshme, që iu ka mundësuar një auditim social, me një përvojë njëjavor nga një trajnim që e kanë mbajtur. Nuk mundesh me i thënë projektit i keq, nëse këtu prokurimi nuk e ka qitur paramasën këtu apo në faqen e komunës, apo emri i inxhinierit Ilir Koraqi si menaxher i projektit, çka e ka penguar projektin, pse i thua i keq projekti, tabela është dashur me përmbajtur këtë. Këto janë të gjetura



për punë teknike , jo që e kanë devijuar projektin. Inxhinieri me kohë e ka hetuar se nuk mundet me vazhduar pa bërë izolimin e podrumit.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Duhet me i falënderuar të gjitha iniciativat sikur kjo në këtë rast që shprehin vullnet me na audituar, me na ndihmuar neve për punët tona me qenë me syqelë në punët tona të përditshme. Pavarësisht a janë profesional apo jo, a ja kanë qëlluar apo jo, ne jemi këtu me debatuar për një çështje ata të cilin e kanë sjellë si raport, i cili me vullnetin tonë është futur në rend pune me debatuar. Munden me qenë të vërteta ato që janë në raport, apo nuk munden me qenë të vërteta që e tha drejtori, si do që të jetë, debat zhvillohet për këtë çështje. Për me pa një punë a është bërë mirë apo keq, njafton me pa edhe me sy. Ne e dimë që kjo ekiye është joprofessionale, se auditorët profesional kanë trajtim tjetër, por ne po mundohemi me trajtuar tamam si një raport të një auditimi, sepse kemi të bëjmë me një projekt që krejt po pajtohemi që është projekt i mirë, por me të gjeturat si në raport t'i diskutojmë. Nuk po pajtohem as me pozitën që po mundohen me çdo kusht me mbrojnë ato të gjetura, as me opozitën që po mundohen ato të gjetura me i rritur, duke thënë se edhe në raporte tjera ka mundësi për të gjetura, dhe me krijuar sinonime edhe për projekte tjera për të gjetura. Pavarësisht a janë profesional apo jo, të gjeturave të ekiye po iu besoj, edhe nëse nuk janë bash ashtu, se duke iu besuar të gjeturave, ne e përmirësojmë vetën në të ardhmen, duke e ditur se dikush po na shef, na bëjnë mirë se ne e përmirësojmë vetën.

**z. Adnan Reka:** Drejtori tha se ekipi nuk është profesional, ekipi është në përbërje 16 veta, secili person është profesional në profesionin e tij, dhe secili i sheh të gjeturat nga keni i vet, për arsye se ka një gazetar, një arkitekt, një administrator, një inxhinier, një zjarrfikës, një roje pyjesh, një aktivist, një profesor, një student. Për mua gjetjet e tyre janë shumë serioze, problemi është se nëse ti i nënçmon dhe nënvlerëson, pse po lejon me të audituar dikush që ti në start po e nënvlerëson punën e tij.

E dyta, Parcelat po thoni se janë pronë komunale, të gjitha varrezat janë në pronë komunale, por çka pas asaj? A duhet të lejoni të ndërtohet mbi varreza se janë prona komunale? Kjo është gabim. Të gjitha ato prona aty, dihen edhe nga qytetarët se quhen varret e tronëve, shumë mirë e kanë cekur ata që eshtra të parëve tanë kanë mundur me u zhdukur dhe nuk i keni hasur, megjithatë janë varreza.

Ekipi i auditimit e ka gjetur se projekti është ndarë në 2 faza, pikërisht aty janë defektet pse është ndarë në faza projekti, kjo është bërë me u dhënë 2 tender. Po të ishte një fazë, gabimet do të ishin me të vogla. Publiciteti i dokumenteve, nuk e di çfarë arsyetimi keni me dhënë, të pjesa ku thuhet:, gjetjet tregojnë se është publikuar kontrata në mes të komunës dhe kompanisë ndërtuese, mirëpo e njëjta nuk ishte e plotë. Në kontratën e publikuar të E- Prokurimi mungonin punët që ishin paraparë të realizohen dhe çmimi për secilin pozicion. Ekipi po ashtu konstatoj se komuna e Kaçanikut nuk i kishte publikuar në mënyrë pro aktive dokumentet tjera, raportet e mbikëqyrjes apo faturat e pagesës. Këtu nuk ka të bëjë, a je profesional apo jo. Në fund, nëse thoni që ky është projekti me i mirë që e ka realizuar komuna. Drejtor, nëse ky projekt është më i miri, atëherë na thoni cili është me i dobëti?

**znj. Ardita Rrahmani:** Drejtor, mungesa e gjerave jo të duhura e krijon këtë kakofoni, që veç u krijua. Ju inkurajoj për hera tjera me qenë me i saktë në atë që e thoni, për me i ikur debateve ndoshta edhe të panevojshme rreth kësaj. E themi të panevojshme, se u bë shumë zhurmë, pse i nevojshëm, se nuk u thanë ato që unë mendoj. Unë prita nga drejtori me na dhënë sqarim, i cili ishte i mangët dhe nxiti debat. Ju drejtor e theksuat se ekipi ka qenë joprofessional. Fillimisht ne duhet me qenë falënderues që jemi nën llupën e dikujt për me pa një projekt që jemi duke e realizuar. Ju e thatë se është projekti me i miri, ndërkaq në bazë të gjetjeve, analizës që është



bërë, nuk po mundemi me menduar sesi janë projektet tjera. Unë nuk mundem, me quajt ekipin joprofesional kur po e shoh se çka kanë paraqitur ky ekip. Kjo grupe punuese ka kërkuar e zhvilluar takime me zyrtarë, kanë me realizuar vizita në terren, kanë pasur kërkesa për qasje në dokumente publike, të cilat i janë ofruar. Unë nuk e di ky ekip çka duhet me bërë me tepër sesa një grup punues, sepse ky ekip të gjitha i kanë kërkuar. Gjetjet e evidentuara, sado që janë të mangëta, unë po uroj që nën llupën e auditorit që ju e cilësoni profesional, me pa sesa të sakta janë këto gjetje, me bërë krahasime, mandej i njëjti debat ka me u zhvilluar edhe atëherë. Uroj që këto të gjetura në praktikë me qenë të kundërta, nga raporti që e kanë bërë DEMOS dhe HELVETAS.

**z. Naim Beça:** Mua po me duket pak si nënçmim i këtyre personave që kanë marrë pjesë në auditim, se drejtori tha: Shikoni listën e ekipit auditues. Ata persona që janë aty, besoj se janë treguar shumë profesional, se nuk iu kanë lënë me bërë gabime. Ndoshta ishte bërë ndërtesa e mirë, por nuk i kishin gjetur si këta këto gabime. Ata janë organizatë dhe shumë mirë që kanë bërë auditim.

**z. Agim Çaka:** Unë përkundrazi, këtë ekip e kisha inkurajuar me marrë iniciativa edhe në projekte tjera, “përkundër që nuk janë profesional”, drejtori e di që e tha gabim, se u mundua pastaj me arsyetuar, se nuk janë ekip i auditimit profesional me efekte juridike. Efektin e ka arritur ky ekip për punën të cilën e kanë kryer. Raportin e kanë sjellë në KK për një projekt, dhe kjo çështje po debatohet me tepër se çdo pikë tjetër dhe qytetarët janë duke na dëgjuar. Të gjitha ato gjetje që i ka gjetur ky ekip, unë i përgëzoj dhe me kanë bërë përshtypje edhe nëse nuk kanë qenë profesional, por sigurisht janë konsultuar me njerëz profesional, dhe i kanë nxjerrë aq mirë të gjeturat, sa që edhe ne si anëtarë të KK po ndihem të shqetësuar për këtë projekt dhe gjitha projektet tjera. Drejtori tha se nuk është asgjë kjo punë, edhe Naimi e potencoj të palestra sportive atje ku është mbledhje uji. Është shumë lehtë me thënë nga pozicioni ku jeni se nuk është lifti, bëhet lifti, ky është fjalor që nuk duhet debatuar para anëtarëve të KK. Ne mundem si anëtar të KK me qenë me të relaksuar, ndërkaq ekzekutivi nuk e ka të drejtën me u shprehur në atë formë. Çështja e emergjencës nuk pret me u bërë punët ngadalë. Unë mendoj se është një prej investimeve me të mira që është bërë deri me tani, është një prej debateve me të mira që e kemi bërë në interes të qytetarëve, me një ekip i cili ka punuar, e përgëzoj për punën që ka bërë dhe është mirë me marrë edhe iniciativa tjera.

**znj. Kadrije Lika-Troni:** Po ndërlihem të mungesa e projektimit për qasje për persona me aftësi të kufizuara, siç e tha drejtori, zëri i përfaqësuesit të HANDIKOS është ngritur aq lartë dhe ka dhënë vërejtje se personat me aftësi të kufizuara nuk posedojnë dhe nuk kanë qasje në objekt. Objekti i ka 2 kate plus podrumi, ndërkaq nuk ka lift. Komuna u arsyetua se nuk ka shumë kate objekti për me pasur lift. Desha me pyetur drejtorin: Sa kate duhet me i pasur objekti, për me iu krijuar qasje personave me aftësi të kufizuara, se nga podrumi plus dy kate tjera, mos me pasur qasje?

**z. Selajdin Troni:** Parcela është ndarë për ndërtimin e objektit të zjarrfikësve, ndërkaq me e mirë ka qenë parcela nën varreza, të tregu i kafshëve se e iu shërben zjarrfikëseve edhe qytetarëve për furnizim dhe intervenim, ndërkaq është sigurt se objekti është ndërtuar mbi varreza, ndërkaq nuk u gjet pronë tjetër komunale. Pronë komunale është edhe kjo ku u ndërtua objekti dhe pjesa tjetër poshtë varrezave, kanë qenë 40 ari aty poshtë, me ndërtua dhe rregullua objektin në formën me të mirë të mundshme, ndërkaq objekti është ndërtuar në pjesën ku është me ngushtë, kështu është kur nuk konsultoheni me banorët e komuniteteve, ndërkaq ballafaqimin me të madh me banorë e kam pasur unë aty.



**z. Ramadush Osmani;** E mirëpres reagimin e juaj, në njëfarë forme kërkoj falje në zhargonin e përshtatshëm të qasjes, mund të jenë prekur edhe dikush tjetër. Ekipi është profesional i fushës së vet, por në auditim jo, këtu ishte qëllimi, me përmirësoj shumë mirë Ardita. Me këtë ekip i pari unë jam takuar dhe kemi rrugëtuar me ta dhe i kemi sqaruar të gjitha detajet. E mirëpres çdo formë se edhe vet janë që 20 vjet në skenë si qytetari aktive, njëherë si administrator. Qytetaria aktive i qet në pah detajet të cilat asnjë drejtor apo inxhinier në një moment të caktuar nuk i sheh. Nuk po dua të kthehem të detajet teknike, ndërkaq të çështja e parcelës, ku është tregu i kafshëve, është parcelë e mirë, por është e destinuar për tjetër çështje, dhe po të ishte caktuar ky lokacion, do të përballemi me problem tjetër, që nuk po dua me theksuar këtu. Arsyeja e ndarjes së parcelës, kemi qenë të detyruar, sepse projektet e DEMOS investojnë në projekte të cilat duhet të përfundojnë dhe aq mjete ka pasur, 70.000€ prej DEMOS, pjesa tjetër është me mjete të komunës. Transparenca është çështja kryesore e ekzekutivit. Nëse këtë përgjigja që po të jap, mund të rangojmë të pjesa e paramasës që nuk ka qenë në faqe të komunës si gabim teknik që hynë në mungesë të transparencës, të cilën është përmirësuar, ka hyrë në faqe të komunës dhe është bërë e qasshme- transparente. Edhe mungesa e emrit inxhinierit futet në elementin e transparencës, e jo të defektet e projektit. Kështu desha me i kanalizuar defektet e gjetura që janë shumë në rregull, janë evidentuar, por disa hynë në domenin e transparencës e disa në domenin e defektit tjetër.. Edhe një herë kërkoj falje juve dhe ekipit, është shkarje e imja, se e kapët këtë detal, është e juaja si opozitë, është e drejtë e juaja, por arsyeja ka qenë që kemi të bëjmë me një ekip të auditimit i cili vjen nga fusha të ndryshme, por për auditim është për herë të parë duke e bërë këtë formë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, konstatoj se Kuvendi i Komunës,

#### **NJOFTOHET**

**Me Raportin e ekipit të Auditimit Social në Kaçanik, Projekti i monitoruar “Ndërtimi i objekteve për zjarrfikësit Kaçanik-Faza e Parë”.**

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 12:55. Në fund Kryesuesi i Kuvendit Uroj për festat e fund vitit, kërkoj të realizohet një foto e përbashkët në sallë të KK, në fund si çdo fund vit tjetër, i ftojë anëtarët e KK për një Drekë pune të Restorant “Beni”.

Procesmbajtëse

Makfire Malsiu

*Makfire Malsiu*

Kryesues i Kuvendit  
Kemal Murseli



REPUBLICA E KOSOVËS  
KOMUNA E KAÇANIK  
OPSTINA KAÇANIK  
REPUBLICA KOSOVA



**REGJISTËR I ANTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**(të zgjedhur në votimet e datës 17 Tetorit 2021);**

**Nga Mbledhja e XI (njëmbëdhjetë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës  
për vitin 2023, mbajtur me 28.12.2023 :**

1. Kemal Murseli .....,
2. Brahim Imishti.....,
3. Hamide Luma .....,
4. Kadri Krivenjeva .....,
5. Fitore Vishi,.....,
6. Rustem Zenuni,.....,
7. Edon Baftiu .....,
8. Selajdin Troni .....,
9. Fatmir Bunjaku .....,
10. Bashkim Krasniqi .....,
11. Florina Lika-Vishi .....,
12. Lejla Muhaxheri-Çaka.....,
13. Agim Mani .....,
14. Kadrije Lika-Troni .....,
15. Adnan Reka .....,
16. Naim Beça .....,
17. Raif Kasa .....,
18. Ernesta Krasniqi,.....,
19. Bashkim Luma .....,
20. Arta Avdiu .....,
21. Ardita Rrahmani .....,
22. Besnik Salihu .....,
23. Betim Shala,.....,
24. Arlinda Rakoci-Raka.....,
25. Rabije Sallahi.....,
26. Ekrem Livoreka.....,
27. Agim Çaka.....,





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kačanik  
Municipality of Kačanik

## Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Kaçanik, 26/01/2024

**Për:** Anëtarët e Kuvendit/ **z. Agim Çaka**

### **Lënda: PËRGJIGJE**

Të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal,

I nderuar z. Agim Çaka ,

Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës, më datë 28.12.2023.

Lidhur me pyetjen tuaj rreth qështjes së punimeve në Stadiumin “ Besnik Begunca “ , ju informojmë se projekti është tenderuar në vitin 2019 ndërsa implementimi ka filluar në vitin 2020. Përshkak të pandemisë ka patur pengesa në implementim, mirëpo komuna ka implementuar të gjitha mjetet e ndara për këtë projekt nga ministria. Pas inflacioneve, kompania ka kërkuar korigjimin e qmimeve ose ndërprerje të kontratës, mirëpo pas takimeve me përfaqësues të ministrisë është udhëzuar që mos të ngutemi me ndërpreje të kontratës deri në prurjen e ligjit për kompensimin e rritjes së qmimeve të materialeve ndërtimore.

Gjatë vitit 2022-2023 nuk ka patur mjete të alokuara nga ministria dhe operatori ekonomik ka bërë kërkesë për ndërprerjen e kontratës meqë rast komuna ka formuar komisionin për prejen e punimeve dhe vazhdimin e procedurave tjera .

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

Hafize Sallahi

Drejtoreshë e DKRS





## Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Kaçanik, 29.01.2024.

**Për: z. Adnan Reka, Këshilltar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut**

Z. Adnan Reka, Këshilltar i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut në Mbledhjen e Kuvendit të Komunës, të datës 28.12.2023 është interesuar për rastin e Bashkim Topojanit, i cili ka kërkuar qasje në dokumente publike për ndërtimin e objektit të aneksit, me etazhitet P+0, të "Posta e Vjeter".

Mund të themi lirisht se nuk qëndron fakti se Z. Bashkim Topojani nuk është dhënë qasje në dokumentet publike për objektin e aneksit të "Posta e Vjeter". Këtë e themi sepse prej tre dokumenteve të kërkuara është gjete vetëm evidenca e pagesës së takses për lejen e ndërtimit, në vlerë 50.70€, në emër të ndërmarrjes NTN "Bardhi". Për dokumentet tjera jo se nuk është dhënë qasje por nuk janë gjetur fare në Drejtorinë (Projekti si dhe Ditari ndërtimor dhe Libri ndërtimor). Rrjedhimisht edhe Kryetari i Komunës nuk kishte sit e mirrte masa apo veprime të caktuara.

Ju faleminderit për bashkëpunimin...

Drejtori i DUKMM-së  
Qamil Stagova







Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

## Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

25.01.2024

Për: Anëtarin e Kuvendit/ **znj. Ardita Rrahmani**



REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



!	Data	25.01.24	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
		02	104/02-2566	/

**Lënda: PËRGJIGJE**

Të nderuar,  
Më lejoni t'ju përgjigjem dhe të jap sqarime zyrtare lidhur me pyetjet/kërkesat tuaja, të parashtruar para Kuvendit të Komunës:

**Znj. Ardita Rrahmani**

### 1.Çka po ndodhë me mjetet e destinuar për Parkingun te komuna?

Pas pranimit të Vendimit 132/2023 nga MKRS më datë 12.10.2023 , jemi obliguar të ndërprejmë punimet në projektin " Ndërtimi i Parkingut Nëntokësorë në Oborrin e Administratës Komunale".

Në seancën e muajit tetor të Kuvendit Komunal , shuma e mjeteve të destinuar për projektin në fjalë 89,662.00 € janë rialokuar në projektin " Rregullimi i Sistemit të Ngrohjes Qendrore në Objektivin e Administratës Komunale".

Ju falenderojmë për bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,

Dardana Tafili Dauti

Drejtoreshë e DAP







Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

### DREJTORIA E ARSIMIT

**Përgjigje në pyetjen e znj. Ardita Rrahmani:** Përse në Çerdhen QEAP "Agimi" u bënë testime rreth ngrohjes, se për 3 ditë nuk ishte funksionale ngrohja e çerdhes ?

**Përgjigje:** Në kuadër të përmirësimit të kushteve në institucionet arsimore, në QEAP "Agimi" ka qenë e planifikuar që të vendoset pompa termike për ngrohje të objektit. Gjatë realizimit të projektit, pasi që janë instaluar të gjitha paisjet, është parqitur problemi i tensionit të ulët në rrjetin elektrik dhe sistemi nuk ka funksionuar si duhet. Tani në bashkëpunim me KEDS-in po presim që të zgjidhet ky problem ndërsa ngrohja është kthyer me sistemin e vjetër.

**Përgjigje në pyetjen e z. Adnan Reka:** Kam një pyetje për drejtorin e DA dhe Drejtorin e DBF: Kur mund të bëhet kompensimi financiar i komunës së Kaçanikut lidhur me borxhin e mbetur sipas kontratës kolektive të arsimit?

**Përgjigje:** Obligimet që rrjedhin nga Kontrata kolektive e arsimit janë në procedurë gjyqësore prandaj me përfundimin e procedurave sigurisht që kryhen edhe obligimet sipas vendimeve të gjyqit.

Me respekt,  
Drejtori Zahir Doda

